

VENDIM
Nr. 16, datë 12.5.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE HETIMORE ADMINISTRATIVE

Në mbështetje të nenit 14 dhe nenit 27, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar dhe nenit 80 e vijues i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të nisë procedurën hetimore për marrjen e masave administrative për kundërvajtjen administrative “Ushtrimi i veprimtarisë pa licencë”, ndaj operatorëve:
 - a) Shoqëria “Ujësjetës-Kanalizime Shkodër” sh.a.;
 - b) Shoqëria “Ujësjetës Shërbime Komunale Krastë” sh.a.
2. Shoqëritë e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi të njoftohen dhe të thirren për t’u dëgjuar mbi objektin e procedimit, sipas grafikut bashkëlidhur.
3. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Sektori Juridik dhe Marrëdhënieve me Publikun.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Avni Dervishi